



Opština Obilić - Municipality Obiliq

Nr. XVI/32 Data 17.05.2022
Br. Datum

Bazuar në Ligjit për Qeverisje Lokale Nr. /L-40, Statutit të Komunës së Obiliqit , Udhëzimi Administrativ Nr.05/2010 për Mbrojtjen e Pyjeve , Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Obiliqit përmes komisionit të formuar me tre anëtarë pasi shqyrtoi Planin Vjetorë të Shoqatës së Gjahtarëve “ROSA“ në Obiliq - Vendgjuetin Qiqavica , morri :

V E N D I M

- I. APROVOHET Plani njëvjeçar i Shoqatës së Gjahtarëve “ ROSA “ në Obiliq 2022/2023, në vendgjuetin Qiqavica në Komunën e Obiliqit.
- II. OBLIGOHET Shoqata “ROSA” në Obiliq, vendgjuetia Qiqavica të respekton kontratën me numër XVI-123 e datës 15.10.2019, të nënshkruar me komunën e Obiliqit si dhe Udhëzimin Administrative NR.8/2008 dhe Udhëzimin Administrativ NR.14/2009.
- III. Vendimi hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural- i përberë me komision profesional pasi që ka pranuar Planin njëvjeçar dhe atë dhjetëvjeçar nga ana e Shoqatës “ROSA” në Obiliq – Vendgjuetia Qiqavica me datë 17.05.2022, komisioni morri në shqyrtim se Shoqata e Gjahtarëve “ROSA” është kontraktuar me Komunën e Obiliqit- Drejtorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të menaxhuar vendgjuetin e përbashkët e quajtur “ Qiqavica” në bazë të Pëlqimit të Ministrisë - komisioni e konstatoi afatshmërin e dorëzimit të Planeve konform Ligjit për Gjueti Nr.02/53 si dhe udhëzimet administrative NR. 08/2008, Për Përmbajtjen , Menyren e Hartimit dhe Procedurave e Aprovimit të Planeve të Menaxhimit për Vendgjueti si dhe udhëzimit administrativ . Komisioni pasi që analizoi në detale plan programin njëvjeçar 2020/ 2021, erdhi në përfundim që konformë ligjeve të aplikueshme dhe udhëzimeve për zbatimin e planeve për gjueti i plotëson kushtet plani një vjeçar që të ushtron aktivitetin e gjuetisë konformë kontratës dhe ligjeve të aplikueshme në vend.

T’ dorëzohet:

- Kryetarit te Komunës,
- Drejtorit të DBZHR-së
- Shoqatës ROSA” në Obiliq
- Arkivit

